



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
SP-084
Prishtinë, më 22 dhe 23 dhjetor 2016

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 22 DHE 23 DHJETOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

Kryetari i hapi punimet e Kuvendit, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare më 19 dhjetor 2016.

Para se të procedohen pikat e rendit të ditës, kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, z. Ismet Beqiri propozoi që dy pikat e përhershme të seancës plenare: Deklarime jashtë rendit të ditës dhe Pyetje parlamentare, si dhe pika e dhjetë e rendit të ditës: Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetit Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë të tjerë lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, të hiqen nga rendi i ditës së kësaj seance, ndërsa shqyrtimi i dytë i Projektligji për faljen e borxheve publike të përfshihet në rende dite, si dhe shqyrtimi i dytë për Projektligjin e Buxhetit 2017 të bëhet po sot, në një seancë të re, me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Deputeti Pal Lekaj, kryetar i Grupit Parlamentar të AAK-së, propozoi që në seancën e sotme, si çështje urgjente, të shqyrtohet ndërtimi i murit në mënyrë ilegale në Mitrovicën e veriut.

Deputeti Bekim Haxhiu propozoi që edhe Projektligji për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në sport të procedohet në shqyrtim të dytë me plotësim të rendit të ditës dhe shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Për propozimet e lartshënuara diskutuan edhe këta deputetë: Zafir Berisha, Daut Haradinaj, Visar Ymeri, Pal Lekaj, Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Teuta Haxhiu, Slavko Simiq dhe Duda Balje, diskutimet e të cilëve janë të përfshira në transkript. Kryetari i Kuvendit i hodhi në votim propozimet e paraqitura.

Kuvendi me shumicë votash vendosi që të përkrahë mocionin e lartcekur të kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri dhe propozimin e deputetit Bekim Haxhiu.

Lidhur me propozimin e deputetit të AAK-së, Pal Lekaj, për ndërtimin e murit në pjesën veriore të Mitrovicës, u vendos që debati të zhvillohet nesër në një mbledhje të veçantë prej orës 15:00.

Më pas, fjalën e mori kryetari i Grupit Parlamentar të Listës serbe, Slavko Simiq, i cili sqaroi arsyet e kthimit të tyre në punën e Kuvendit, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryetari i Kuvendit i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i propozon Kuvendit për emërim deputetin Fatmir Shurdhaj në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në vend të deputetit Fadil Demaku.

Kuvendi e miratoi njëzëri propozimin e lartshënuar të GP të PDK-së.

Pastaj, Kuvendi i zhvilloi punimet me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga seancat e mëparshme

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 30 nëntor dhe 1 dhjetor 2016.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Kryesuesi i seancës, Sabri Hamiti i njoftoi deputetët se Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Para se të procedohet me shqyrtimin e këtij projektligji, Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri, propozoi që shqyrtimi i parë dhe shqyrtimi dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 të bëhet sot, me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Ismet Beqiri.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 66,
Kundër----- 24,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, bëhet më procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara më nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit, si në vijim:

1.1. Pas miratimit në shqyrtim të parë të Projektligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, në seancën plenare më 22 dhjetor 2016, Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme: Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Komisioni për Integritet Evropian duhet ta shqyrtojnë Projektligjin nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime për seancën e re plenare që do të mbahet më 22 dhjetor 2016.

1.2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, bëhet në seancën e re plenare më 22 dhjetor 2016.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Pastaj, kryesuesi e ftoi ministrin e Financave, Avdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe të arsyetojë Projektligjin nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Ministri Avdullah Hoti, ndër të tjera, u shpreh: “Ky projektbuxhet bazohet plotësisht në dokumentet strategjike që i ka të aprovuara Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, përfshirë këtu edhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, Programin e Qeverisë dhe Programin për reforma ekonomike”. Duke folur për investimet e parapara, ministri Hoti sqaroi në detaje investimet në secilin sektor të paraparë. Me këtë projektbuxhet, vijoi ministri, synojmë të arrijmë dy objektiva: të krijojmë hapësirë më të madhe për investime kapitale, si dhe t'i mbajmë nën kontroll shpenzimet rrjedhëse.

Pasi që njoftoi se projektbuxheti i propozuar është i harmonizuar në tërësi me qëndrimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, ministri u shpreh i bindur se buxheti i paraparë për vitin që vjen do ndikojë në një rritje ekonomike më të lartë se 4%.

Më pas, fjalën e mori kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, i cili në fillim të fjalës së tij tha se Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar këtë buxhet, duke trajtuar të gjitha kërkesat zhvillimore dhe kërkesat e tjera, në mënyrë që ato t'i mbështesim nëpërmjet këtij buxheti. “Si kryeministër i vendit vlerësoj se kemi arritur që Republikës së Kosovës në vitin 2017 t'i ofrojmë një buxhet, i cili siguron zhvillim dhe i cili reflekton në mënyrë të drejtpërdrejtë programin tonë qeveritar, programin e koalicionit qeveritar, si përkushtim tonin të përbashkët për zhvillimin e vendit, si përkushtim për rritjen ekonomike, për krijimin e vendeve të reja të punës, për mirëqenien sociale dhe po ashtu edhe për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit”. Si tërësi, diskutimi i kryeministrit është dhënë në transkript.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa foli kryetari këtij komisioni, Naser Osmani, i cili vuri në pah punën e komisionit lidhur me këtë projektligj, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së fjalën e mori deputetja Safete Hadërgjonaj, nënkryetare e Komisionit për Buxhet. Ajo, ndonëse shprehu pakënaqësi lidhur me këtë projektligj, si dhe shfaqti dyshime në mundësinë e implementimit të tij, në fund bëri të ditur se Grupi Parlamentar i PDK-së do ta përkrahë atë.

Për Projektligjin e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017 diskutuan: deputetja Besa Gaxherri, në emër të GP të LDK-së, Myfera Shinik, në emër të GP “6+”, Visar Ymeri, në emër të GP të LVV-së, Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së dhe Enver Hoti, në emër të GP “Nisma”, si dhe deputetët: Daut Haradinaj, Faton Topalli, Shpejtim Bulliqi, Besa Baftiu, Blerim Grainca, Shaip Muja, Time Kadrijaj, Shqipe Pantina, Fatmir Rexhepi, Salihe Mustafa, Ali Berisha, Besim Beqaj, Rexhep Selimi, Sali Morina, Emilija Rexhepi, Bali Muharremi, Aida Dërguti, Qerim Bajrami, Salih Salihu, Teuta Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Lahi Brahimaj, Mytaher Haskuka, Flora Brovina, Veton Berisha, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqu, Hajdar Beqaj, Bekim Haxhiu, Hatim Baxhaku, Shukri Buja, Abdyl Ymeri, Naim Fetahu, Arben Gashi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Nehat Baftiu, Blerta Deliu-Kodra, Melihate Tërmkollli dhe Fisnik Ismajli, diskutimet e tyre janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 73,
Kundër----- 20,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në bazë të Vendimit të Kuvendit nr. 05/L-394, datë 22 dhjetor 2016, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdimi i mbledhjes plenare më 23 dhjetor 2016

Mbledhjen e hapi dhe e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, me vazhdimin e pikave të rendit të ditës të filluar më 22 dhjetor 2016.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbime

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi ministren e Tregtisë dhe Industrisë, znj. Hykmete Bajrami, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja znj. Hykmete Bajrami, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin në parim rreth këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për shërbime diskutuan: Rustem Berisha, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Sala Berisha-Shala, në emër GP të PDK-së, Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së, Ali Berisha, në emër të GP të AAK-së dhe Valdete Bajrami, në emër të GP “Nisma”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për shërbime.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Ligji për shërbime.
1. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmën shtetërore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Znj. Safete Hadërgjonaj, zëvendëskryetare e Komisionit Funkcional, para deputetëve e paraqiti dhe e arsyetoi projektligjin.

Në projektligj ishin propozuar 26 amendamente nga Komisioni Funkcional. Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet prej 1-26, të cilat edhe u miratuan.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-100 për ndihmën shtetërore.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Znj. Safete Hadërgjonaj, zëvendëskryetare e Komisionit FunkSIONAL para deputetëve e paraqiti dhe e arsyetoi projektligjin.

Në projektligj ishin propozuar 10 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL dhe deputeti Faton Topalli pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet prej 1-10. Kuvendi i miratoi amendamentin 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9 dhe 10, të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL dhe nuk i miratoi amendamentet 1 dhe 5, të propozuara nga deputeti Faton Topalli, pa përkrahjen e komisionit.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 58,
Kundër----- 10,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, z. Nait Hasani, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet prej 1-23. U miratuan të gjitha këto amendamente, edhe pse për amendamentin 17 pati diskutime nga disa deputetë dhe ministri i Financave, megjithatë ai u miratua ashtu siç ishte propozuar nga Komisioni FunkSIONAL për Arsim, diskutimet e deputetëve dhe të ministrit janë dhënë në transkript.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 55,
Kundër----- 5,
Abstenime----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për faljen e borxheve publike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Znj. Safete Hadërgjonaj, zëvendëskryetare e Komisionit FunkSIONAL para deputetëve e paraqiti dhe e arsyetoi projektligjin.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në këtë projektligj janë propozuar 3 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL. Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet nga 1-3.

Amendamentet u miratuan siç ishin propozuar nga Komisioni FunkSIONAL, megjithëse rreth amendamentit 2 pati diskutime nga disa deputetë për plotësim të tij, i cili nuk u përkrah nga Kuvendi, diskutimet e tyre janë dhënë në transkript.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se për ta hedhur në votim projektligjin në tërësi nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

* * *

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për faljen e borxheve publike u votua në seancën plenare të mbajtur më 29 dhjetor 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 70,
Kundër----- 12,
Abstenime-----02.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-043 për faljen e borxheve publike

8. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në bazë të vendimit të seancës plenare, datë 22 dhjetor 2016, procedohet me shqyrtimin e dytë të projektligjit.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zoti Nait Hasani, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet nga 1-19, të cilat u miratuan nga Kuvendi.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se për ta hedhur në votim projektligjin në tërësi nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

* * *

Projektligji për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive u votua në seancën plenare të mbajtur më 29 dhjetor 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	80,
Kundër-----	00,
Abstenime-----	02.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me rekomandime.

Kryesuesi e ftoi znj. Sala Berisha-Shala që në emër të Komisionit FunkSIONAL të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit me rekomandime.

Znj. Sala Berisha-Shala e paraqiti të plotë raportin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, së bashku me rekomandimet.

Lidhur me raportin dhe rekomandimet diskutuan edhe deputetët: Muhamet Mustafa, Shaip Muja dhe Fatmir Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se për ta hedhur në votim raportin nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

* * *

Raporti i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet u votua në seancën plenare të mbajtur më 29 dhjetor 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62,
Kundër----- 09,
Abstenime-----02.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës në orën 16:55 min.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale